



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PASTRIMIT DHE GJELBËRIMIT**

Nr. prot.

Tiranë, më .2023

**PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM  
TE KONTRATES ( MARREVESHJE KUADER) PER 36 MUAJ  
ME OBJEKT PROKURIMI; “FUNIZIMI ME VAJRA LUBRIFIKANT PER  
MJETE, ALKOOL FRENASH, GRASO ETJ”**

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “FUNIZIMI ME VAJRA LUBRIFIKANT PER MJETE,  
ALKOOL FRENASH, GRASO ETJ”** bazuar ne nenin 42 dhe 52 te Ligjit 162/2020 “Per  
Prokurimin Publik” si vijon:

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):**

(24951400-9) (24951400-9) (24951100-6) (24951000-5).

**Vlera e Fondit Limit të Marreveshjes Kuadër është: 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milion)  
lekë pa TVSH.**

I mbajtur sot më date **27.04.2023** në DPPGJ – Tirane, në prani të anëtarëve të Njësisë së Prokurimit të ngritur me Urdhër të Titullarit të AK, , për miratimin e dokumentave të tenderit « Tender i hapur» , me mjete elektronike, marreveshje kuader me nje operator ekonomik ku te gjitha kushtet jane te percaktuara duke gjetur zbatim referuar nenit 52 pika 3 e Ligjit 162/2020 «Per Prokurimin Publik dhe neneve 59, 60, 61,62, 63, 64 pika 1 germa «a» dhe «i» si dhe pika 2 e VKM 285 date 19.05.2021 «Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik» , marreveshje kuader me afat 36 mujor nga data e lidhjes se marreveshjes kuader sipas sasise dhe grafikut te levrimit si mëposhte:

**FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT**

**Sasia e mallit që kërkohet per 36 muaj:**

Nr.	Emërtimi i Mallit	Sasia në Litra ose Kilogram
1	Vaj Motorri 10w-40	3000 Litra

2	Vaj Motorri 15w-40	3000 Litra
3	Vaj Motorri 20w-50	2400 Litra
4	Vaj Hidraulik 68	2400 Litra
5	Vaj Hidraulik 46	2700 Litra
6	Vaj Kambio 80w-90	1800 Litra
7	Vaj Michele 2T	600 Litra
8	Vaj Diferenciali 75w-90	1800 Litra
9	Vaj Hidraulik 10w-30	1200Litra
10	Graso	600 Kg
11	Alkool Frenash	450 Litra
12	Antifrizë	2700 Litra
13	AD BLUE	1500 Litra

**Afatet e lëvrimit:** Sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor, por në çdo rast jo me vonë se 10 (dhjetë) ditë nga nënshkrimi I kontratës

Per objektin ne reference.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, DPPGJ, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Shtojca 7**

**“Funizimi me vajra lubrifikant per mjete, alkool frenash, graso etj”**

**FORMULAR I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT**

**1.KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT** të pa ndryshueshme nga ato të miratuar nga APP në setin standart të dokumentave të tenderit.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

#### **2.1.Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarim, sipas shtojcës 8*)

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, njësia e prokurimeve bazuar në natyrën dhe përmasat e kontratës, specifikimet teknike, sasia e kerkuar e mallit, gjykon që pjesë e kriterëve të vecanta për kualifikim të jenë dhe kriteret e tjera teknike, me qëllimin kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës, konkretisht njësia gjykon vendosjen e kriterëve si vijon :

#### **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

**2.2.1** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2020, 2021, 2022), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit.. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 39 % e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43 pika 1 dhe pika 2 germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësia ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjykojnë me të arsyeshme të sjellin edhe vërtetimin.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin Nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të të ardhurat”, i ndryshuar, neni 29.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros së kërkuar është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj. Vlera e xhiros është vendosur që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

---

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2020, 2021, 2022) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Për të rritur pjesmarrjen, për të rritur konkurrencen dhe gjithëpërfshirjen, njësi ka kërkuar që paraqitet deklaratë për plotësimin e kriterit, si kriter minimal, por gjithashtu duke i lënë mundësinë operatorëve që në cdo rast nqs e gjejnë me të arsyeshme të sjellin edhe bilancet.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin Nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij.

Kërkesa për paraqitjen e bilanceve është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” e ndryshuar, për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda **datës 31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor*

të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese:

"c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:**

- i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh;
- ii) ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh;
- iii) iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

**Kritere të veçanta të pranimit, lidhur me kapacitetin teknik , jane argumentuar nga grupi i punes i ngritur me Urdher Nr. 734 Prot date 24.04.2023, specialistet e fushes nisur nga natyra dhe permasat e kontrates, specifikimet teknike, grafiku i levrimit , fushes se veprimtarise se institucionit, konkretisht si vijon:**

### **2.3 Kapaciteti teknik:**

**2.3.1 Operatori** ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ose/dhe faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

---

Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të

*fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike<sup>2</sup>. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.*

**2.3.2** Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **5 persona** per periudhen **Janar 2023 – Mars 2023**. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

a) *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për periudhen Janar 2023 – Mars 2023.*

**Argumentimi:** Kërkesa e AK është e bazuar në në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 2, 3, 5ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. Bazuar në ‘Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë’ si dhe ‘Vendim Nr. 1025, Datë 16.12.2020 Për Përcaktimin e Pagës Minimale në Shkallë Vendi’. Bazuar në VKM e sipër cituar, koeficienti i shërbimit përlllogarit në 4.98 (Ore pune/punonjes/muaj: **total 174 ore**). AK gjykon se numri i punonjesve te kerkuar eshte nje numer minimal prej 5 (pese) punëtorë, duke patur parasysh: 1 (nje) administrator biznesi, 1 (nje) magazinier, 1 (nje) shofer per transport malli dhe 2 (dy) punonjes ngarkim-shkarkim malli, numer i cili bazohet edhe mbi tiologjine e kesaj kontrate mbi kufirin e larte monetar dhe me nje kohezgjatje prej 36 muajsh. **Kërkesa e AK i referohet numrit minimal prej 5 punonjesish për kryerjen e shërbimit**

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.*

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të paraqesë fletë analizë për vajrat objekt prokurimi të lëshuar nga ISHTI, e cila duhet të jetë **jo më parë se 6 muaj nga data e hapjes se ofertave, por qe**

*pranohen edhe nga laboratorë të tjerë nderkombëtarë të çertifikuar për analizat e vajrave(ose ekuivalent).*

***Shënim: Kriteri per te cilin kerkohet flete analiza vlen per mallrat te cilat jane te cilësuar sipas tabelës si me poshtë:***

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i Mallit</b>
<b>1</b>	<b>Vaj Motorri 10w-40</b>
<b>2</b>	<b>Vaj Motorri 15w-40</b>
<b>3</b>	<b>Vaj Motorri 20w-50</b>
<b>4</b>	<b>Vaj Hidraulik 68</b>
<b>5</b>	<b>Vaj Hidraulik 46</b>
<b>6</b>	<b>Vaj Kambio 80w-90</b>
<b>7</b>	<b>Vaj Michele 2T</b>
<b>8</b>	<b>Vaj Diferenciali 75w-90</b>
<b>9</b>	<b>Vaj Hidraulik 10w-30</b>

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 36 dhe 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 44 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që OE të kenë kapacitetet e duhura teknike për përmbushjen me sukses të kontratës.

Gjithashtu theksojmë se: Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial ushtron inspektime në fushën e përpunimit, transportimit dhe tregtimit të naftës dhe gazit dhe **nënprodukteve të tyre**, e garantimit të sigurisë së njerëzve dhe vlerave materiale nga rreziqet e shfryrjeve dhe të shpërthimeve të shkaktuara nga paisjet nën presion, si dhe nga paisjet dhe instalimet elektrike, si dhe ushtron funksionin e tij rregullator në përputhje me nevojat e vendit, të mbrojtjes kombëtare dhe të sigurimit publik, duke respektuar parimet e ekonomisë së tregut. Drejtoria e Laboratorit Qëndror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit në Inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial ka për qëllim të analizojë të gjitha nënproduktet e naftës së tregtueshme si: gazol, benzinë, vajgur avionash, **vaj lubrifikant**, lëndë djegëse (mazut dhe solar), gaz të lëngshëm, bitum, bioetanol dhe biodieseli. Ky kriter është menduar për ti dhënë sigurinë AK që OE

ofertues nuk eshte penalizuar nga autoritetet përkatëse për abuzim me cilësinë e nënprodukteve të karburanteve (vaj lubrifikant), duke ofruar një garanci se nuk do të ketë të tilla abuzime as me sasinë e vajrave lubrifikant të prokuruar.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'.*

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet të deklarojë se disponon magazine në pronësi ose qera për magazinimin e mallit objekt prokurimi, vërtetuar me një nga format e disponimit sipas Kodit Civil (kontratë noteriale, akt pronësie ose të jenë të pasqyruara në ekstraktin e QKR, etj) .

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 40, pika 5,6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Ky kriter është vendosuar për të provuar se OE ka eksperiencë në fushën e tregtimit të vajrave lubrifikantë (nënprodukteve të karburanteve) dhe ka kapacitetet e domosdoshme për përmbushjen e kontratës.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) 'Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik', si dhe pika 6 e këtij neni: 'Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin'.*

**2.3.5** Dëshmi për mjetet e transportit, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës.

Nr.	Mjetet	Sasia	Gjendja
1	Automjet me autovinç per shkarkim malli me kapacitet <b>deri në 10 Ton.</b>	1	Pronësi ose me qira



- *Për mjetet që shënohen në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) taksat vjetore, e) certifikatën e transportit nga pushteti vendor.*
- *Për mjetet e marra me qera duhet të paraqitet: a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit; b) leje qarkullimi; c) çertifikatën e kontrollit teknik; ç) siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); d) taksat vjetore, e) certifikatën e transportit nga pushteti vendor.*
- *Për mjetet e marra me qera të paraqitet kontrata përkatëse noteriale e qirasë ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*
- *Për secilin mjet të deklaruar duhet të paraqesë foto ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.*
- *Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

OE duhet të ketë një mjet të llojit automjet me autovinç për të kryer lëvrimin e mallit (transportin dhe shkarkimin) për shkarkim malli me kapacitet **deri në 10 ton** në ambientet e AK. Nevoja për një mjet të llojit autovinç i referohet sasisë dhe peshës së mallit të kërkuar nga AK, ku ndër të tjera mund të përmendim fuçinë e grasos e cila kërkohet me peshë neto (150 kg).

Eshtë në të drejtën e Autoritetit Kontraktor të kërkojë garanci për realizimi me sukses të projektit, duke përfshirë kërkesat për mjetet të cilat nevojiten për kryerjen dhe realizimin me sukses të kontratës.

*Bazuar në Nenin 26, pika 2 (gj; h) ‘Vendim Nr. 285, Datë 19.5.2021 për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik’, si dhe pika 6 e këtij neni: ‘Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin’.*

**2.3.6.** Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këto kontrate, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikate të leshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara

nga DPA, ose organizma nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, qe kane lidhje me objektin e kontrates, si me poshte:

- Shoqeria duhet të paraqesë Çertifikatë të cilësisë së punimeve **ISO 9001- 2015** (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO).

*Ne rastin e bashkimit te operatoreve Certifikatat e mesiperme duhet te paraqiten nga secili OE.*

**Argumentimi:** Ky kriter u vendosën në përputhje me parashikimin e nenit 36 dhe nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 44, të VKM-seNr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ne baze te Njoftimit të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr.2502 Prot., date 09.04.2021, si dhe ligjit nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, ku percaktohet se kjo Çertifikate duhet të jetë lëshuar nga organizma çertifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur aftësinë e tyre për te kryer sherbimin objekt kontrate. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente.

## **ISO 9001:2015**

ISO 9001 është standardi më popullor i publikuar në nivel ndërkombëtar. Ai përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë të cilat mund të implementohen dhe certifikohen nga çdo shoqëri, pavarësisht dimensionit të saj apo fushës së aktivitetit.

Kërkesat e ISO 9001:2015 i referohen aspekteve të ndryshme siç janë: implikimi në menaxhim, identifikimi i riskut dhe mundësive, sigurimi i konkurrencës për personelin e shoqërisë, mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës, matja e kënaqësive të klientëve, përgjigje ndaj ankesave të marra dhe vlerësimi i furnitorëve.

Certifikimi ISO 9001 përfaqëson një konfirmim të faktit që shoqëria respekton një seri kërkesash të pranueshme në nivel ndërkombëtar. Mbajtja e certifikimit sjell disa përparësi për shoqërinë siç janë: akses tek procedurat e tenderave publike, marrëdhënie biznesi me partnerët e njohur apo një imazh më të mirë në sytë e klientëve.

Bazuar ne pikën 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet : “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla*”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njësuar me origjinalin*”.

**2.3.7** Operatori ekonomik, ditën e hapjes së ofertave, duhet të depozitojë pranë AK mostrat e artikujve si mëposhtme të shoqëruara me fletë analizën përkatëse:

<b>Nr.</b>	<b>Emërtimi i Mallit</b>	<b>Monstra qe duhet te parqesë OE e shprehur sasia në Litra ose Kilogram</b>
<b>1</b>	<b>Vaj Motorri 10w-40</b>	<b>1 -20 Litra</b>
<b>2</b>	<b>Vaj Motorri 15w-40</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>3</b>	<b>Vaj Motorri 20w-50</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>4</b>	<b>Vaj Hidraulik 68</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>5</b>	<b>Vaj Hidraulik 46</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>6</b>	<b>Vaj Kambio 80w-90</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>7</b>	<b>Vaj Michele 2T</b>	<b>1-5 Litra</b>
<b>8</b>	<b>Vaj Diferenciali 75w-90</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>9</b>	<b>Vaj Hidraulik 10w-30</b>	<b>1-20 Litra</b>
<b>10</b>	<b>Graso</b>	<b>0.4 -5 kg</b>
<b>11</b>	<b>Alkool Frenash</b>	<b>1-5 Litra</b>
<b>12</b>	<b>Antifrizë</b>	<b>1-5 Litra</b>
<b>13</b>	<b>AD BLUE</b>	<b>1-5 Litra</b>

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar nenin të 36, dhe 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 6/a dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe *Udhezimit nr. 03 date 12.04.2022* ”Mbi Procesin e Administrimit te Monstrave te paraqitura nga Operatoret Ekonomike”.

Paraqitja e mostrave të kërkuara lidhet drejtpërdrejtë me verifikimin e përputhshmërisë së specifikimeve teknike të produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me ato të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Autoriteti Kontraktor është në të drejtën e tij të bazuar në legjislacionin e prokurimit publik dhe akteve nënligjorë të nxjerra ne zbatim te tij, për të kërkuar mostrat e mallrave, objekt prokurimi, për verifikimin e përputhshmërisë së tyre me specifikimet teknike, Vetë Komisioni i Prokurimit Publik lidhur me këtë kriter, arsyeton: ...”KPP konstaton se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi, të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave për te gjitha artikujt objekt prokurimi...”

Qëllimi i vendosur nga ligjvënësi për paraqitjen e mostrave, është dhënia e mundësisë autoritetit kontraktor, i cili është përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, të kryerjes së verifikimeve (ekzaminim, inspektim, testim) të mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik në rast se këto të fundit janë në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor të pasqyruar në specifikimet teknike të procedurës së prokurimit.

*(Shënim: Autoriteti/enti kontraktor, në varësi të natyrës së objektit të prokurimit, mund të përcaktojë kritere të tjera të vecanta, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës, duke argumentuar teknikisht dhe ligjërish çdo kriter, duke përcaktuar, sipas rastit, aktin ligjor/nënligjor që parashikon domosdoshmërinë e kriterit në fjalë).*

*Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Specifikimet teknike, kriteret dhe perlllogaritja e fondit limit, për procedurën objekt prokurimi janë hartuar nga grupi i punës miratuar nga titullari i AK me Urdher Nr.734 Prot, date 24.04.2023 ,bazuar ne parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, , nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo dhe çdo standardi të kërkuar

**Përsa i përket përlllogaritjes së fondit limit të kontratës,** theksojmë se grupi i përlllogaritjes së fondit limit është bazuar VKM Nr.285, datë 19.05.2021, Neni 76.

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); **ose/dhe**

**b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe**

c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

**Autoriteti/enti kontraktor mund t’i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.**

Ne rastin konkret AK i është referuar nenit 76 pikes 1 germa “b” te VKM Nr.285, datë 19.05.2021 ” Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”.

Gjithashtu AK sqaron gjithë OE e ineteresuar se momenti i paraqitjes se dokumentacionit provues per kerkesat qe perfshihen ne formularin permbledhes se vetedeklarimit , do te behet perpara publikimit te njoftim fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, bazuar kjo ne percaktimet e nenit 26 , pika 6 te VKM Nr. 285/2021 i ndryshuar ku përcaktohet:

***Te gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre.***

***Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skuklifikim.***

